

VENDIM
Nr. 71, datë 6.2.2026

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË TIRANË TË NJË OBJEKTI
PUBLIK

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të Bashkisë Tiranë të një objekti publik, sipas listës së inventarit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Lista e të dhënave për Godinën TIP në RSU 3 (nr.3)

Nr.	Qarku	Bashkia	Njësia Administrative	Niveli	Emërtimi i Kontratës	Tipologjia e ndërhyrjes	Finacimi i ndërtimit	Sipërfaqe Total Ndërtimi (m2)	Vlera e projekt ide	Vlera e projektit të zbatimit dhe ndërtimit	Vlera e Mblqyrjes së Punimeve	Vlera e Kolaudit të Punimeve	Vlera Totale
1	Tiranë	Tiranë	Tiranë	Konvikt për studentë	Ndërtimi I Godinës TIP në RSU 3 (nr.3)	Ndërtim i ri	Rindërtim	6,290	251,250	306,499,632	2,766,160	109,000	309,626,042